

## STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT

### IL PAESE 31 sh.p.k

Sot ,me date **16.01. 2025** (dymije e njezet e pese) jemi personalisht ortaket themelues si me poshte:

1. Znj. Entela Peza, shtetase shqiptare, e bija e Havase dhe Danailit lindur në Tirane me 19/06/1973 banues ne Tirane, mbajtes i leternjoftimit 028592604 me nr personal H35619023K madhore e me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Hartoj kete Akt themelimi te Shoqerise "IL PAESE 31 "SHPK me emer tregtar 'IL PAESE 31', mbeshtetur ne ligjin 9901 date 04.04.2008" per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare" dhe ligjin nr. 9723 date 03.05.2007 Per Qendren Kombetare te Regjistrimit vendosen te themelojne shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar me emrin IL PAESE 31 shpk.

#### KAPITULLI I

##### Neni 1

##### Krijimi

- 1.1. Shoqëria do të quhet IL PAESE 31 shpk eshte person juridik I te drejtes shqiptare, shoqeri me pergjegjesi te kufizuar . (Këtu e më poshtë "Shoqëria")

##### Neni 2

##### Personaliteti juridik

2.1. Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jete regjistruar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

2.2 Shoqeria, pasi te kete fituar personalitetin juridik eshte pergjegjese ndaj te treteve per detyrimet dhe demet e shkaktuara gjate veprimtarise se saj.

2.3 Shoqeria IL PAESE 31 SHPK eshte nje shoqeri qe themelohet me nje ortak qe perballon humbje vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre ne kapitalin themeltar



### **Neni 3**

#### **Selia**

Shoqeria e ka seline ne Tirane ne adresen Rruga e Konferences nr 2, Peze e Madhe , Tirane. Shoqeria mund te ndryshoje seline e tij, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendimin e ortakeve te shoqerise.

### **Neni 4**

#### **Objekti dhe kohezgjatja**

4.1. Objekti i aktivitetit të shoqërisë është: Restorant dhe organizim eventesh dhe muzik live si dhe do te zhvilloje cdo aktivitet tjeter qe nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar mund te kryeje sipas ligjit.

4.2 Kohezgjatja e veprimtarise te shoqerise IL PAESE 31 shpk eshte e pakufizuar.

## **KAPITULLI II**

### **KAPITALI THEMELTAR**


#### **NENI 5**

##### **Kapitali Themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100000 lekë ( njeqind mije lekë ) i përbërë nga 1 kuote.

znj Entela Peza zotëron 100 % te kapital te shoqërisë ne vlere 100000lekë (njeqind mije lekë)

Kapitali mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimit te asamblese se ortakeve themelues. Kuota e Pjesmarresve ne kapital jane te gjitha te emruara dhe te pa ndashme.Kapitali eshte teresisht i shlyeshem dhe i nenshkrueshem. Cdo kuote i takon e drejta e nje vote.



## **NENI 6**

Ortaku qe ka ndermend te shesi kuotat e tij teresisht, apo pjesisisht duhet me pare te njoftoje ortakun tjetër te shoqërise. Ortaku tjetër ka te drejten e blerjes se pare. Kete te drejta ortakut duhet ta ushtroje Brenda 30 Diteve nga dita e njoftimit.

Ne rastin e mos ushtrimit te se drejtes se blerjes se pare, ortakut qe do te shese kuotat duhet te njoftoje emerin e blesesit dhe kushtet, te cilat nuk duhet te jene me te favorshme se sa ato te afruara ortakut tjetër te shoqërise.

## **NENI 7**

Kapitali i shoqërisë përbehet, nga kapitali fillestar plus shtesën e bere, mjetet e xhiros, pasuri te luajtshme ose te paluajtshme etj te nevojshme për ushtrimin e aktivitetit te shoqërisë.

## **NENI 8**

Kuotat e kapitalit janë te pasqyruara dhe te regjistruara ne librat e llogarisë te shoqërisë.

## **NENI 9**

Heqja dore e ortakut nga bashkëpunimi nuk e çliron ortakun e larguar nga detyrimet qe kane lindur para se ai te largohet. Po kështu ai fiton dhe te drejtat qe janë krijuar para largimit te tij .

## **NENI 10**


Fitimet qe realizohen gjate veprimtarisë dhe qe konkretizohen me nxjerrjen e bilanceve periodike, ndahen midis ortakëve ne proporcion me përqindjen e kapitalit te investuar, por kurdoherë pasi të jenë shlyer detyrimet ligjore.

Kapitali i investuar nga ortakët nuk mund te zvogëlohet nen kufijtë e parashikuar ne ligj .

## **NENI 11**

Shoqëria tregtare "IL PAESE 31 " sh.p.k. është përdoruese dhe disponuese e pasurisë se saj. Ajo mund te blejë dhe te shfrytëzoje te drejta te tjera, material ose jo material, duke përfshire edhe te drejtën për shitjen e pasurive se vet tek te tjerët.

Ne Republikën e Shqipërisë Shoqëria tregtare IL PAESE 31 sh.p.k. gezon te drejta sikundër çdo person tjetër juridik, shqiptar ose i huaj ne përputhje me legjislacioni ne fuqi.



## **NENI 12**

Shoqëria tregtare “\_IL PAESE 31” sh.p.k. vepron ne regjimin e pronës private dhe merr përsipër te drejtat e detyrimet vetëm brenda kufirit te kapitalit te saj. Ortaket themelues te shoqërisë, mbartin rrezikun e veprimtarisë se shoqërisë, vetëm ne nivelin e kuotave te kapitalit te investuar ne te. Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet qe ortakut kane pasur para se ajo te krijohet.

## **KAPITULLI I III**

### **DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE**

## **NENI 13**


### **Organi Vendimarrës**

**13.1** Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimarrës i shoqerise

**13.2** Asambleja e ortakeve eshte ogani i vetem vendimarrës i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme

- A) Percaktimi te politikave tregtare te shoqerise
- B) Ndryshimin e statutit
- C) Emertimin dhe shkarkimin e administratorit
- D) Emertimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar
- E) Percaktimin e shperblimeve per personat e permendur me larte
- F) Mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret perfshire dhe pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore te ecurise se veprimtarise
- G) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
- H) Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitlit
- I) Perpjestimin e kuotave dhe anullimin e tyre
- J) Perfagesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedura te tjera ndaj administratoreve
- K) Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise
- L) Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese
- M) Kreditimin e cfaredo banke apo institucioni financiar kreditor
- N) Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti



#### **NENI 14**

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj *znj Entela Peza*

#### **NENI 15**

##### **Administrimi i shoqërisë**

**15.1** Administratori ka te gjitha te drejtat dhe fuqite per drejtimin e zakonshëm te shoqërisë, me qellim qe te arrije objektivat e saj, përveç atyre qe ligji ia atribuon ortakeve.

**15.2** Administratori përfaqëson shoqërinë ne mardhenie me te tretet si dhe para organeve te administratës dhe atyre gjygesore.


**15.3.** Administratori përgjigjet individualisht ndaj shoqërisë ose ndaj te treteve per shkelje te ligjeve, për shkelje te statutit apo per deme te kryera gjate administrimit.Ortaku ka te drejte te ngrej padi ndaj administratorit.

**15.4** Administratori emerohet dhe shkarkohen me vendim te ortakut, kan të drejtë të veproj, firmosi pranë çdo organi administrativ, banke të nivelit të dytë dhe ku të shikohet e arsyeshme për të ushtruar aktivitetin e shoqërisë.

**15.5** Shoqeria administratohet te pakten 1(nje) dhe maksimumi 3(tre) administrator , te cilet qendrojne ne detyre deri ne revokimin apo doreheqjen per nje periudhe maksimale prej (5 vjetesh

**15.6.** Çdo administrator do te ketë te drejte për rimbussimin e shpenzimeve te bera prej tij per llogari te shoqërisë .

**15.7** Kur administrator i shoqerise rezulton i sukseshem ne punen e tij dhe ne rezultatin financiar te kompanise atehere ortakët vendosin lidhur me shperblimin qe do ti jepet atij ne fund te vitit financiar .



## NENI 16

### Detyrat e Administratorit/ëve

Administratori i shoqërisë ka dhe këto detyra dhe te drejta.

- Te mirë administroje pasurine e shoqërise
- Te lidhe marrëveshje me te tretet Brenda objektit te veprimtarise se shoqërise dhe kompetencave te caktuara nga ortaket.
- Te zbatoje rregullat e brendeshme te shoqërise
- Te shperbleje demet qe l vijnë shoqërise si pasoje e veprimeve apo mos veprimeve te tij.
- Te paguhet per punen e kryer ne baze te marrëveshjes se bere midis tij dhe ortakeve.
- Te marre te dhena e te beje propozime mbi gjithcka qe ai e quant e dobishme per shoqërine
- Te miratoje planet e llogarive ekonomike pas perpunimit te tyre dhe ti paraqese ato sipas rastit per miratimin perfundimntar nga ortaket
- Te behen prpozimet perkatese ortakut te vetem kur lind nevoja per ndryshime ne kapitalin themeltar te shoqërise.
- Te miratoje aktet normative qe percaktojnë aportet ne gjirin e shoqërise duke perfshire kuadrin e personelin
- Te percaktoje strukturen e aparatit te shoqërise dhe te krijojne organe te tjera te domozdoshme per realizimin e objektivave te shoqërise.
- Ti propozoje ortakeve per krijimin e enjesive strukturave te ndryhsme si filial, dege e e përfaqësi ne qytetet te tjera te vendit ose jashte shtetit.
- Te përgatise propozimin për pushimin e veprimtarisë se shoqërise dhe t'ia paraqesë ortakut për miratim. Të përzgjedhë ekspertin kontabël dhe anëtare te komisionit te likuidimit si dhe te paraqes propozimet për miratim para ortakeve .
- Te siguroje zbatimin e përpikte te Vendimeve te Ortakeve.
- Te kryeje çdo detyre tjetër qe i ngarkohet nga ortakut i vetem i shoqërise.

### KREU III MARDHENIET E PUNES

#### **NENI 18**

Marrëdhëniet e punës ne shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratave te punës. Për çeshtjet qe kjo kontrate nuk l parashikon zbatohen dispozitat përkatëse te legjislacionit shqiptar ne fuqi.

#### **NENI 19**

Për çdo mos marrëveshje qe mund te lind midis palëve dhe qe nuk zgjidhet me mirëkuptim apo konsensus, organi kompetent për zgjidhjen e saj është Gjykata e rrethit Gjyqësor Tirane.

#### **NENI 20**

##### **Sekreti i punës**

Te gjithë të punësuarit ne shoqëri janë të detyruar të ruajnë sekretin e punës së shoqërisë Kjo detyre vazhdon edhe pas largimit te tyre nga shoqëria.

#### **KAPITULLI I IV**

#### **VITIT FINANCIAR, BILANCI VJETOR SHPERNDARJA E FITIMIT**

#### **NENI 21**

##### **Viti financiar**


Vitit financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti.  
Përjashtimisht Viti I pare financiar përfshin kohen nga data e regjistrimit te shoqërisë ne regjistrin tregtar dhe përfundon me 31 dhjetor te te nje viti.

#### **NENI 22**

##### **Baza Ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.  
Per sa nuk parashikohet ne kete statut dhe akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit " per tregtaret dhe shoqerite tregtare, kodi civil dhe cfaredolloj ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise

#### **NENI 23**



### **Raportet vjetore**

**23.1.** Ne fund te cdo viti financiar, Administratori harton bilancin vjetor dhe raportin e administrimit, te cilet i dergohen ortakeve per miratim

**23.2** Per te gjitha ceshtjet qe nuk jane parshikuar ne kete statut do te zbatohen parashikimet e ligjit per shoqerine tregtare ne fuqi te azhornuar

### **NENI 24.**

#### **Rezerva e domosdoshme dhe e nevojshme.**

**24.1** Nga fitimi i realizuar gjate vitit financiar pasi zbriten humbet e vitit te mëparshëm, hiqet men je ane një shume e barabarte me 5 %(pese perqind) e fitimit e destinuar për formimin e fondit rezerve te quajtur "rezerve e domosdoshme ".

**24.2** Heqja nga fitimi për rezervën e domosdoshme pushon se qeni e detyrueshme kur kjo rezerve arrin 10 % te kapitalit themeltar. Ajo rifillon kur për një arsye çfarëdo, rezerva e domosdoshme ka zbritur nen 10% e kapitalit.

**24.3** Ortaket mund te vendosin edhe zbritje te veçante ne favor te rezervave te jashtëzakonshme ose për qëllime te tjera apo për shtyrjen e shpërndarjes se fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare te ardhshme.

### **NENI 25**

Te ardhurat eventualisht te ndjekura nga shoqëria çdo vit financiar janë te destinuara siç është vendosur nga ortaket duke i qëndruar ne uljen 5 % qe do ti destinohet rezervës ligjore.


### **KAPITULLI V**

#### **MBYLLJA E SHOQERISE, LIKUJDIMI**

### **NENI 26**

Veprimtaria e shoqërisë mund te ndërpritet para afatit kur shoqëria nuk rezulton rentable gjate dy vjetëve te fundit radhazi dhe kur për këtë vendos gjykata kompetente.

### **NENI 27**



**27.1** Menjëherë pas marrjes së vendimit për prishjen e shoqërisë, ortakët caktojnë një likuiditor, kompetencat e tij dhe mënyrën e likuidimit të shoqërisë, me dispozitat përkatëse të ligjit tregtar. Shoqëria gjatë likuidimit mban anash emërtimit dhe emrin "Shoqëri në Likuidim e sipër".

**27.2** Likuiditori i emëruar nga ortakët menjëherë sapo merr detyrën është i detyruar të publikojë bilancin e shoqërisë duke specifikuar aktivin dhe pasivin dhe t'ia vënë në dispozicion menjëherë ortakëve.

**27.3** Me miratimin e likuidimit shoqëria i jep fund veprimtarisë.

## **NENI 28**

Ortakët vendosin mbi rregulshmerinë e likuidimit, për të vendosur për bilancin e likuidimit dhe heqjen e mandatit të likuiditorit.

Ortakët mund të vendosin vetë realizimin e kësaj mbledhje, në rast se likuiditori nuk e kërkon. Mbledhja vendoset edhe nga gjykata mbi propozimin e Ortakëve ose të një mandatmbajtësi të caktuar prej tij.

## **NENI 29**

Kur ortakët për shkaqe të arsyeshme nuk vendosin për aktet e mësipërme, likuidatori dhe çdo person i interesuar mund të kërkojë nga Gjykata mbylljen e likuidimit.

Aktet e mbylljes dhe likuidimit e depozitimit të dokumentacionit në regjistrin tregtar Shoqëria regjistrohet prej tij.

## **DISPOZITET KALIMTARE**

### **NENI 30**

#### **Dispozitat perfundimtare**

**30.1** Ky statut përben dokumentin e vetëm të shoqërisë që parashikon themelimin dhe organizimin e veprimtarisë së shoqërisë. Ky Statut mund të ndryshohet, rishikohet dhe / ose shfuqizohet pjesërisht ose tërësisht dhe të zëvendësohet me një status të ri vetëm me vendimin e ortakëve.

Ky statut u redaktua në 4 ekzemplare me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqip dhe u nënshkrua nga palet pa asnjë rezervë.

### **NENI 31**

**Gjykata kompetente.**



### **NENI 31**

#### **Gjykata kompetente.**

Gjykata kompetente per zgjidhjen e te gjitha mosmarveshjeve dhe interpretimin e Statutit te Shoqërisë është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.

### **NENI 32**

#### **Hyrja ne fuqi**

Ky Statut dhe Akt themelimi hyn ne fuqi dhe eshte i detyrueshem per zbatim ne momentin e firmosjes nga Ortaket.

### **ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE**

**" IL PAESE 31 " sh.p.k.**

*ENTELA PIZZ*  
